

NJË QASJE METODOLOGJIKE: GABIMI NË MATJE I ANKETIMIT KUR NUK MERRET NË KONSIDERATE NDRYSHIMI I MJEDISIT SOCIO-POLITIK (RASTI I SONDAZHEVE ZOGBY NË SHQIPËRI)

***ALEKSANDËR KOCANI, BLERTA DERHEMI**

Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Tiranës, Rr."Gjon Buzuku", Nr.115, Tiranë.

Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti Jo Publik UFO, Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

Email: alkocani@gmail.com

PËRMBLEDHJA

Në shoqëritë e pa emancipuar politikut, ndryshe nga ato të emancipuar, nuk mund të përdoret një kampionim që nuk siguron anonimin e respondentit kur atij i drejtohen pyetje delikate. Në të kundërt, në matjet do të futet një gabim shtesë që supozohet përcaktues për parashikimin që bën anketimi. Një gabim të tillë metodologjik supozohet të ketë bërë sondazhi Zogby i zbatuar në elektoratin shqiptar në 3-4 muajt para zgjedhjeve të 28 Qershor 2009. Një eksperiment me dy anketime të njëjta, që ndryshojnë vetëm nga sigurimi ose jo i këtij anonimit, u krye që të llogaritej praktikisht marzhi i gabimit të bërë në këtë rast. Rezultoi se, në rastin më të mirë, ky marzh ishte i rendit 15-26%, që përbënte afro gjysmën e pritmënisë së studimit (prej 30-40%), por ende përcaktues ndaj zgjedhjeve. Analiza nxjerr si shkak për këtë rezultat mos izolimin apo veprimin e faktorëve dytësorë ndaj faktorit bazë të studimit (identifikueshmëria/mos identifikueshmëria e respondentëve). Këta faktorë dytësorë me një punë më të kujdesëshme mund të minimizohen.

Fjalët çelës: Gabim i matjes, premisa të fshehta, skemë logjike e anketimit, anonimat i respondentit, sinqeritet i përgjigjeve, mjedis socio-politik.

ABSTRACT

For the societies without political emancipation, diversely from the emancipated one, it is not allow to use sampling which dont provides the respondent to be anonymous and questionnaire with delicate questions. Otherwise you will have a supply error in measurment, supposed to be determinant for the survey prognosis. Such a methodological error is supposed to be made by Zogby's survey fulfilled on the Albanian electorate during 3-4 month before elections of June 28-th 2009. An experiment with two identic

questionnaires, but distinguishing in the providing or not of the anonymous situation, is realized to calculate pratically the error's margin made in this case. It resulted that, at best this margin was at the level 15-26%, around a half of thw predicted by the study (30-40%), but still determinant towards elections. By the analysis it was concluded as the reason for this result, the action of secondary factors towards the study basic one's (to be anonymous or not for respondents). These secondary factors could be minimized with a careful proceeding.

Tema përmban rezultatet e një studimi eksperimental të kryer në periudhën Mars – Qershor 2009 në qytetin e Tiranës. Nxitja për të ndërmarrë këtë studim ka qenë paraqitja në mediat elektronike dhe të shkruara e rezultateve dhe e metodologjisë së realizmit të sondazheve Zogby në Republikën e Shqipërisë për një periudhë disa mujore para zgjedhjeve të 28 Qershorit të vitit 2009.

Motivimi për t'i hyrë këtij studimi ishte përdorimi i një pyetësori me pyetje "delikate" dhe një kampionimi që identifikon respondentët, i cili në një shoqëri politike relativisht pak të emancipuar, si ajo shqiptare, shpie në një ulje të supozuar të vlefshmërisë së të dhënave të anketimit (1, 93-94), (2, 183), (4, 235).

Argumenti i studimit qëndron në sa vijon. Pyetjet delikate (për preferencat partiake dhe të liderve partiakë) në një shoqëri politike, që nuk realizon praktikisht mos pasjen e pasojave për shprehjen e lirë politike, mund të gjenerojnë natyrshëm përgjigje jo të sinqerta nga respondentët. Mbështetje për këtë supozim janë përqindjet e larta të mosbesimit ndaj tjetrit (mbi 90%) nga anketimet e mëparshme në rang vendi e Tirane dhe shifrat në mbi 60% të respondentëve në Tiranë (anketimi i muajit prill 2009) që pohojnë se mund të kesh pasoja në se shpreh lirisht preferencat partiake.

Studimi synonte llogaritjen me një eksperiment social të marzhit të gabimit që bëhet gjatë hetimit të sjelljes votuese të elektoratit të qytetit të Tiranës, kur kalohet nga intervistimet që i identifikojnë respondentët, në ato që nuk i identifikojnë ata. Kjo llogaritje përbënte njëherazi testin empirik të hipotezës së studimit.

Nga pikëpamja metodologjike, studimi përbënte në thelb një eksperiment social që kërkonte të masë kufijtë e gabimit që bëhet kur në një anketim, që heton sjelljen votuese të elektoratit, kalohet nga një kampionim që ruan anonimin e respondentëve, në një tjetër të ngjashëm që bën të mundur identifikueshmërinë e respondentëve nëse atyre u bëhen pyetje të tipit delikat (3, 92), (4, 270-271). Kjo, në kushtet e një shoqërie politike të pa emancipuar deri në atë masë sa të garantoj lirinë e shprehjes politike të zgjedhësve. Në tema të tilla, qëndrimi krijues që mbajnë studjuesit përfshin jo vetëm zgjedhjen e instrumenteve njohëse (si tipi i kampionimit, pyetësi etj.), por edhe shqyrtimin kritik të premisave të fshehta të arsytimit të përdorura në skemën logjike të anketimit në një mjedis të caktuar socio-politik. Nënkuptimi i këtyre premisave edhe në rastet e ndryshimit të mjedisit socio-politik ku zhvillohet anketimi mund të rezultojë i gabuar. Kjo sepse mjedisi i ri mund të kërkojë premisa të ndryshme nga të parat. Mos ndryshimi i tyre mund të shpjegojë në përfundime të gabuara në arsyetim dhe, për rrjedhojë, në rezultate të papranueshme të matjeve me anketim të bazuara në skemën logjike që përfshin një arsyetim të tillë. Kështu një anketim, të themi, në SHBA pranon skemën logjike që presupozon se identifikimi i respondentit nuk ndikon në shkallën e sinqeritetit të përgjigjeve edhe kur pyetet për preferencat partiake apo të liderve partiakë. Nuk ndodh kështu në vendet me shoqëri politike relativisht pak të emancipuar si Shqipëria. Këtu identifikimi i preferencave të tilla perceptohet nga respondentët si me pasoja të konsiderueshme, gjë që ndikon në sinqeritetin e përgjigjeve. Për të siguruar këtë sinqeritet në këto vende, lipset të zgjidhen kampionime që në hallkën e fundit lejojnë anonimin e respondentëve. Këtë nuk ka marrë parasysh në premisë sondazhi Zogby (kampionimi i tij e identifikon respondentin, të cilit i bëhen pyetje delikate), sepse është bazuar në realitetin e një shoqërie politikisht të emancipuar siç është ajo e SHBA. Transplantimi i kësaj premise përbën bazën logjike të gabimit metodologjik që ky sondazh bën. Dhe eksperimenti i kryer synonte ta llogariste pikërisht marzhin sasiar të tij.

Të dy anketimet në kuadrin e eksperimentit u realizuan njëkohësisht (paralel) dhe në të njëjtin vend (me të njëjtin kampionim). Veçse njëri siguronte anonimin e respondentëve nëpërmjet përzgjedhjes në hallkën e

fundit të kampionimit të respondentëve me kuotë sipas gjinisë dhe grup moshës. Kurse tjetri ndiqte metodën sistematike për përzgjedhjen e familjeve ose mjediseve të punës, duke përcaktuar në to individin që kishte ditëlindjen më të afërt. Pra, një metodë të afërt me atë të ndjekur nga sondazhi Zogby. Pyetësi i eksperimentit kishte pyetje që hetonin preferencat partiake dhe vlerësimin për liderët partiakë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, ndryshe nga ai i sondazheve Zogby. Pritej që kjo ta zvogëlonte disi marzhin e diferencave, por nuk e cënonte në parim eksperimentin.

Në skemën logjike të arsytimit mbi të cilën mbështetej testi empirik i eksperimentit përfshiheshin si premisa edhe supozime që konsideronin se të gjithë faktorët me përjashtim të faktorit identifikueshmëri /mosidentifikueshmëri, mbeten të pandryshuar gjatë eksperimentimit (4, 229). Kështu, për shembull, supozohej se grupi i intervistuesve sillet në mënyrë kompakte (sikur të jetë «vetëm një intervistues»), se të gjithë ata janë të trajnuar e të kualifikuar në një shkallë të kënaqshme, se gjatë intervistimeve në terren nuk shfaqen situata të paparashikuara nga trajnimi për intervistues të veçantë, se hedhja e të dhënave është tepër korrekte etj. Mirëpo një situatë e tillë hipotetike zor se ndeshet realisht. Kështu që, më e pritshme, ishte prania edhe e ndikimit të faktorëve të tjerë, që lidhen me mosrealizimin e këtyre premisave ideale. Çështja shtrohej që të bëhej sa të ishte e mundur për t'i shmangur apo minimizuar ato. Kurse për ato faktorë që nuk do të shmangeshin, të gjendej mënyra për të çvlerësuar ndikimin e tyre. Kjo me qëllim që të mund të konsiderohej, me një gabim të pranueshëm të matjeve, se pothuaj kemi vetëm një faktor në shqyrtim në kuadrin e eksperimentit tonë.

Lidhur me pritmënitë e hipotezës së eksperimentit, me që në anketimet do të përfshiheshin mbi 100 intervistues (nga 55 për secilin), gjë që e ul cilësinë e intervistimeve dhe, me që shkalla e frikës për pasojat nga shprehja e lirë e opinionëve politike e matur në fillim të muajit Prill 2009, rezultonte në afro 60%, u supozua, në rastin më të mirë, një marzh i gabimit në nivelin e 30% - 40%. Natyrshëm pritej që marzhi i gabimit në fjalë të ishte më i vogël, se sa ai që do të merrej në se do të përdorreshin pyetje delikate më të drejtpërdrejta (si ato të përdorura nga sondazhet Zogby).

REZULTATET E STUDIMIT

Nga përpunimi i të dhënave dilte se, për një grup pyetjesh të përzgjedhur si «më delikate», kishte një diferencë që shkonte nga **9%-17%** në përgjigjet e siguruar nga anketimi ku respondentët ishin të identifikueshëm dhe atij ku ata ishin të pa

identifikueshëm. Ky rezultat ishte përcaktues në raport me parashikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 28 Qershorit. Por, ai përbënte më pak se gjysmën e pritmënisë së hipotezës së studimit. Natyrisht ai tregonte se me gjasë kanë vepruar mbi rezultatin faktorët e supozuar si jo veprues.

Për të testuar supozimin mbi veprimin e faktorëve të neglizhuar, u ndërtuan nga baza e plotë dy baza të pjesëshme (të përzgjedhura nën këndvështrimin e paksimit të mundshëm të efektit të këtyre faktorëve): një bazë që përzgjidhte të dhënat e siguruar nga përgjigjet e 4 pyetësorëve të parë (nga 10-12 të tillë) për çdo intervistues. Kjo sepse, nga vëzhgimet, dilte se intervistuesit tregonin më shumë kujdes në realizimin e 4-5 intervistave të para. Më tej lodhja ndikonte negativisht në cilësinë e tyre. Baza e dytë u ndërtua duke përzgjedhur 15 çifte intervistuesish homologë nga të dy anketimet të vlerësuar si më pozitivë në punë. Baza e parë e thjeshtuar jep një marzh ndryshimi që shkon nga **11%** deri në **19%**. Pra, mesatarisht **2-4%** më të lartë se ai i siguruar nga baza fillestare. Kurse baza e dytë e thjeshtuar jep marzhin **15-26%**. Pra, kemi një rritje mesatarisht me **6-9%** kundrejt atij fillestar. Kjo rritje e marzhit të gabimit flet për bën test pozitiv të supozimit se cilësia e intervistave ndikon në këtë marzh.

Test tjetër pozitiv jo i drejtpërdrejtë për supozimin bazë të studimit janë diferencat midis çifteve të përgjigjeve ndaj pyetjeve lidhur me pjesmarrjen në votim dhe cili duhet preferuar në votim, partia apo kandidati. Pritej që ato për të parën të ishin të vogla, sepse anketimet paraardhëse parashikonin shkallë relativisht të lartë pjesmarrjeje në votime. Prandaj, mund të konsiderohej ajo si pyetje që nuk i bënte të ndjeshëm respondentët ndaj qenies së tyre të identifikueshëm. Logjikisht kjo “përkthehej”: në çiftet përkatëse, me gjasë, nuk duhej pritur ndonjë diferencë me peshë. E njëjta situatë ishte edhe për pyetjen e dytë. Edhe ajo pritej të mos perceptohej nga respondentët si “me spec”. Për rrjedhojë, nuk pritej të prodhonte diferencë të ndjeshme në çiftin përkatës të përgjigjeve. Rezultoi një diferencë prej **1-2%**, pra e pakonsiderueshme.

DISA PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

1. Nuk u konstatua diferenca e pritur (rreth 30-40%) në përgjigjet ndaj pyetjeve “delikate” sipas dy anketimeve. Arsyeja qëndron në supozimin e realizimit të një eksperimenti në kushte ideale (pa faktorët e mundshëm ndikues në rezultat, me përjashtim vetëm të faktorit identifikueshmëri/mosidentifikueshmëri, që hetohej nga studimi). Një mundësi e tillë, ndërkohë, ishte parashikuar në metodologjinë e studimit bashkë

me mënyrën se si do të veprohej në rast të kundërt (dy bazat e pjesshme).

2. Rezultati i arritur sugjeron që të bëhen ndryshime të rëndësishme sidomos në “instrumentat” e përdorur. Kështu, ndoshta do ndryshuar pyetësi i anketimeve. Me sa duket, ai ka të ngjarë të jetë i kapërcyer. Pyetësi i përdorur bazohej në testimin e hipotezës se ka një tendencë në rritje të shkallës së abstenimit të elektoratit të Tiranës, gjë që ishte konstatuar në anketimet e viteve 2003, 2005, 2007 dhe 2008. Mirëpo anketimi paraprak (Prill 2009) si dhe anketimet e eksperimentit treguan që pritmënia e shkallës së abstenimit dilte relativisht mjaft më e vogël (afro 11%). *Kjo ulje e ndjeshme ka të ngjarë që ta ketë “topitur” instrumentin e “pyetësorit”. Domethënë, e ka bërë atë jo të përshatshëm për matje në kuadrin e eksperimentit në fjalë.* Natyrshëm që dobësimi i mjetit matës do të sillte edhe një rritje të gabimit të pritmënisë së parashikuar. Nga **30 - 40%** e pritur, eksperimenti nxjerr marzhin **15% - 26%**. Pra, diçka mbi gjysmën e pritmënisë. Dhe vetëm në një rast, atë të pyetjeve lidhur me kënaqësinë/pakënaqësinë nga jeta që bënin tani, diferenca shkoi deri në **43%**.

3. Pavarësisht nga kjo, mund të thuhet se konfirmohet një nga supozimet bazë të eksperimentit: ekzistenca e një gabimi përcaktues (si parashikim të zgjedhjeve) të rezultateve të anketimeve që nuk marrin në konsideratë sigurimin e anonimitatit të respondentëve. Mund të thuhet se eksperimenti ia arriti që të përcaktojë kufirin e poshtëm të këtij gabimi (në nivelin e **15-26%**), i cili shihet që është dukshëm përcaktues në parashikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 28 Qershorit.

4. Edhe ballafaqimi i parashikimeve të bëra nga sondazhet Zogby (dhe të tjerëve) afër ditës së votimit, për një pritmëni të diferencës së mbështetjes prej afro **8%** më shumë për PD kundrejt PS, me rezultatet e votimit të 28 Qershorit, nxjerr një moskonfirmim të tyre. Por, ndryshe nga interpretimet e saj si dështim të sondazheve në tërësi, mendojmë se në këtë rast mospërputhja vjen nga zbatimi jo korrekt i metodologjisë së anketimeve. Kjo njëkohësisht përbën edhe një konfirmim empirik të hipotezës së studimit tonë.

5. Në mungesë të disponimit të parashikimeve nga sondazhet Zogby për qytetin e Tiranës dhe të rezultateve zyrtare të votimit po për këtë qytet, nuk mund të bëjmë një krahasim midis diferencave të tyre dhe diferencave përkatëse që lidhen me parashikimet e bëra nga anketimi pa identifikueshmëri i eksperimentit. Për më tepër, nuk mund ta bëjmë këtë krahasim për parashikimet e bëra për PS dhe PD. Kjo, sepse eksperimenti u mbyll në 10 ditëshin e parë të muajit maj, ndërkohë që sondazhet Zogby u bënë edhe

gjatë muajit qershor. Nga ana tjetër distanca kohore midis 10 maj dhe 28 qershor është relativisht e madhe për një fushatë intensive që zhvilloan PD dhe PS. Ndaj nuk shkon që të krahasohen parashikimet për rezultatet e mundshme të PD dhe PS nga eksperimenti, me vetë rezultatet e votimit. Por mund të sjellim në këtë drejtim një krahasim, atë të parashikimit të rezultatit prej 5% për LSI në qytetin e Tiranës nga eksperimenti me rezultatin prej 5.1% që dha votimi për qarkun e Tiranës. Po të supozojmë se afërsisht po kaq është rezultati për qytetin e Tiranës (me që vetë vlera në rang vendi është e rendit 5.95%), atëherë mund të merret ky rezultat i LSI si një konfirmim empirik i parashikimit të bërë nga eksperimenti.

6. Si sugjerim për të ardhmen, mendojmë të synohet identifikimi i faktorëve shtesë, që ndërhyjnë në këtë eksperiment. Domethënë, të kërkohet të shmangen

ndikimet sidomos të shkaktuara nga përdorimi i instrumentave matës jo adekuatë (si pyetësorët e pa përshtatshëm, intervistuesit e pa kualifikuar, numri i lartë i intervistuesve, monitorimi jo rigoroz i intervistimeve etj.).

BIBLIOGRAFIA

1. Bernstein, R. A., Dyer J. A. *An introduction to Political Science Methods*, Prentice Hall Englewood Cliffs: New Jersey.
2. Kelly, D.L, *Measurement made accessible*, Sage Publications 2000, International Education and Professional Publisher.
3. Kocani, A., *Metodat e kërkimit sociologjik*, Tiranë, UFO 2006.
4. Feraj, H.,. *Shkenca politike(Një hyrje)*, Tiranë, Pegi. 2004.